



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:092675
Datë: 04.10.2024
Numri i dokumentit: 06252670

K.DH.Shk II.nr. 261/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “ Teuta Ergisi”, Sh.p.k, me seli në Gjakovë, kundër debitorit M.D., BI, nga Carabregu i Epërm, Komuna e Deçanit, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, me numër unik të lëndës 2022:092676, me datë **02.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit M.D.-BI nga Carabregu i Epërm, ndërsa aktvendimi Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, me numër unik të lëndës 2022:092676, i datës 22.12.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Deçan, me aktvendimin e atakuar me numër unik të lëndës 2022:092676, i datës 22.12.2022, në dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit M.D.-BI nga Carabregu i Epërm, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.114/22 i lejuar me datë 21.03.2022, nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, 2022:092676, i datës 22.12.2022.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm; Faturës nr. 037 të datës 24.02.2021 ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 114/22 i lejuar me datë 21.03.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që në ta paguaj borxhin në shumë prej EUR 169.80.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se është bërë shkelje e dispozitave ligjore dhe procedurale, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe cenimit të drejtës materiale, duke kërkuar nga gjykata që prapësimi i debitorit të aprovet në tërësi si i bazuar.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar në kuptim të nenit 73 par.1 pika 3 të LPP-së.

Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Deçan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar me numër unik të lëndës 2022:092676, i datës 22.12.2022, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit M.D.-BI nga Carabregu i Epërm, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.114/22 i lejuar me datë 21.03.2022, nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se fatura 037 të datës 24.02.2021, paraqet dokument të besueshëm ndërsa debitori të njëjtën nuk e ka përmbushur gjegjësisht nuk e ka kryer obligimin ndaj kreditorit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës të lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e

pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës e dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, konsideron se fatura si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohet si dokument i besueshëm. Po ashtu, fatura është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali dhe mbanë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit. Andaj, fatura nr. 037 e datës 24.02.2021 është nënshkruar nga debitori dhe konsiderohet si pranimit i rregullt.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se fatura nuk është nënshkruar në mënyrë të rregullt nuk përmban vulën e protokollit, por që këto pretendime i vlerësoj si të pabazuara, pasi që në vlerësimin e Gjykatës, me nënshkrimin e faturës mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi dhe atë pa kundërshtim është pajtuar me borxhin që rrjedh nga fatura.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.261/24 me datë 02.10.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami